



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.108

18 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.822, datë 18.6.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar 4779
Vendim i KM nr.825, datë 14.5.2008	Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, të punonjësve të shëndetësisë dhe për një shtesë në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave ... 4780
Vendim i KM nr.826, datë 4.6.2008	Për lejimin e kalimit transit të një automjeti ushtarak italian, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë 4782
Vendim i KM nr.827, datë 11.6.2008	Për hapjen, pranë universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) dhe për mënyrën e funksionimit të tij në periudhën kalimtare ... 4783
Vendim i KM nr.828, datë 4.6.2008	Për miratimin e rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës” 4786
Vendim i KM nr.829, datë 4.6.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Evropiane për Turizmin” 4792
Vendim i KM nr.830, datë 4.6.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia”” 4793
Vendim i KM nr.831, datë 4.6.2008	Për hapjen dhe mbylljen e disa programeve të studimit, të ciklit të parë, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2008-2009 4794
Vendim i KM nr.832, datë 4.6.2008	Për hapjen dhe mbylljen e disa programeve të studimit, të ciklit të parë, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, për vitin akademik 2008-2009 4795

Vendim i KM nr.833, datë 4.6.2008	Për hapjen dhe mbylljen e programeve të studimit, të ciklit të parë, në universitetin “Fan S.Noli”, Korçë, për vitin akademik 2008-2009	4796
Vendim i KM nr.834, datë 11.6.2008	Për një shtesë në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””, të ndryshuar ...	4796
Vendim i KM nr.835, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit, të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që u ofrohet investitorëve strategjikë	4797

VENDIM
Nr.822, datë 18.6.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Para paragrafit të fundit të shkronjës “b” të pikës 3 të kreut III “Dokumentet e tenderit”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- i) çmimin e bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për botim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;
- iii) marzhin e fitimit, të shprehur në vlerë absolute dhe në përqindje.”.

2. Pas shkronjës “b” të pikës 2 “Mbikëqyrja e kontratës” të kreut VIII “Ekzekutimi i kontratës”, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.

Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen, e rritjes apo të uljes, të çmimit të bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të livruar, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë.”.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të dërgojë çdo javë për botim, në Buletinin e Njoftimeve Publike, çmimin e bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, dhe Agjencia e Prokurimit Publik të bëjë ndryshimet përkatëse në dokumentet standarde të tenderit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.825, datë 14.5.2008

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË EDUKIMIT NË
VAZHDIM, TË PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË DHE PËR NJË SHITESË NË
VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, të punonjësve të shëndetësisë, si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, për nxitjen dhe zhvillimin profesional të të gjitha kategorive të personelit të shëndetësisë, me synim rritjen e njohurive dhe zhvillimin e aftësive, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim do të shërbejë si agjenci teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për:

- planifikimin, bashkëpunimin dhe zbatimin e programeve të formimit të vazhdueshëm të punonjësve të shëndetësisë;

- bashkërendimin e punës dhe realizimin e procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të zhvillimit profesional, pa përfshirë programet, që varen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e strukturat e saj;

- procesin e certifikimit të personelit të shëndetësisë;

- realizimin e studimeve të vlerësimit të nevojave për formim të vazhdueshëm, për kategori të ndryshme të punonjësve të shëndetësisë ose për sektorin e shëndetësisë, në përgjithësi;

- vënien në zbatim të programeve të trajnimit, përmes mobilizimit dhe kontraktimit të universiteteve, shkollave universitare, institucioneve akademike, si dhe organizatave të specializuara, shqiptare ose të huaja;

- funksionimin, si bazë informacioni për veprimtaritë e formimit të vazhdueshëm profesional, dhe si bazë dokumentacioni, për materialet pedagogjike, të përdorura gjatë këtyre veprimtarive;

- mbështetjen, rritjen e njohurive dhe përmirësimin e aftësive për teknikat andragogjike (pedagogjia për të rriturit) të trajnerëve, në fushën e shëndetësisë;

- bashkëpunimin me institucionet arsimore, që përgatisin specialistë të shërbimit shëndetësor, si dhe me të gjitha institucionet shëndetësore e organizatat profesionale, në mbështetje të procesit të certifikimit të personelit, në fushën e shëndetësisë.

3. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj qendre rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

Mënyra e funksionimit dhe rregullimi i marrëdhënieve në punë të punonjësve përcaktohen në rregulloren e qendrës, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

4. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i drejtorit të qendrës bëhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin dhe lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Qendrës janë:

- Hartimi i planit kombëtar të veprimtarive të formimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional të punonjësve të shëndetësisë, të cilin e dërgojnë, për miratim, në Ministrinë e Shëndetësisë.

- Zbatimi i planit kombëtar të formimit të vazhdueshëm dhe të zhvillimit profesional, që miratohet nga Ministria e Shëndetësisë.

- menaxhimi i fondeve buxhetore, që jep Ministria e Shëndetësisë për formimin e vazhduar, si dhe nxitja për çeljen e fondeve nga burime të tjera financimi.

- Bashkërendimi i veprimtarive të trajnimit, që organizohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga donatorët e organizatat e financuara prej tyre.

- Bashkërendimi dhe akreditimi i programeve të trajnimit të vazhdueshëm, si dhe i veprimtarive të tjera të zhvillimit profesional.

- Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet arsimore, që përgatisin specialistët e shërbimit shëndetësor, si dhe me të gjitha institucionet shëndetësore e organizatat profesionale, në mbështetje të procesit të certifikimit të personelit, në fushën e shëndetësisë.

- Emërimi, lirimi a shkarkimi i stafit të qendrës, mbështetur në përshkrimet e vendeve të punës dhe në aktet ligjore në fuqi.

- Përfaqësimi i qendrës në marrëdhënie me të tretët.

6. Pranë qendrës funksionon këshilli konsultativ, si organ këshillimor i drejtorit.

Këshilli përbëhet nga tetë persona:

a) Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë;

b) Përfaqësuesi i Institutit të Shëndetit Publik;

c) Përfaqësuesi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor;

ç) Përfaqësuesi i Fakultetit të Mjekësisë;

d) Përfaqësuesi i Fakultetit të Infermieristikës;

dh) Përfaqësuesi i Urdhrit të Mjekut;

e) Përfaqësuesi i Urdhrit të Infermierëve;

ë) Përfaqësuesi i Urdhrit të Farnacisë.

7. Qendra duhet të bashkëpunojë me Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Infermierisë, si dhe urdhërat e profesionistëve për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të edukimit në vazhdim.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, dhe organika e qendrës të përballohen, përkatësisht, nga buxheti dhe numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për vitin 2008, për Ministrinë e Shëndetësisë.

9. Në lidhjen I, kreu 1.9, të vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar, të shtohet emërtimi “Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim të punonjësve të shëndetësisë”.

10. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

STRUKTURA E QENDRËS KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL




Tabela nr.2

ORGANIKA E QENDRËS KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Drejtoria	
Drejtori	1
Sekretare	1

SEKTORI I VLERËSIMIT, PLANIFIKIMIT, KOORDINIMIT

Shef sektori	1
Specialist	2

SEKTORI I ZBATIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Shef sektori	1
Specialist	2

SEKTORI I AKREDITIMIT

Shef sektori	1
Specialist	2

SEKTORI PEDAGOGJIK DHE TEKNIK

Shef sektori	1
Specialist	1

SEKTORI ADMINISTRATËS DHE FINANCËS

Shef sektori	1
Specialist	2
Shofer	1
Pastruese	1

Gjithsej 18

VENDIM

Nr.826, datë 4.6.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOMJETI USHTARAK ITALIAN,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2 , 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një automjeti ushtarak italian, së bashku me 3 (tri) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 4 qershor 2008, dhe lejimin e kalimit transit të po këtij automjeti dhe të trupave në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 5 qershor 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, më 4 qershor 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin të Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Automjeti dhe trupat italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.827, datë 11.6.2008

**PËR HAPJEN, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, TË
FAKULTETIT TË STUDIMEVE TË INTEGRUARA ME PRAKTIKËN (FASTIP) DHE PËR
MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË TIJ NË PERIUdhËN KALIMTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9, 41 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të Fakultetit të Studimeve të Integrueshme me Praktikën, (FASTIP). FASTIP-i e zhvillon veprimtarinë e vet në kuadër të këtij universiteti, por gëzon status autonom, për drejtimitet e veprimtarisë, që përcaktohen në këtë vendim.

2. FASTIP-i kalon një periudhë kalimtare, që zgjat 4 vjet (2008-2012), gjatë së cilës do të organizohet në departamentet e mëposhtme:

- a) Departamenti i menaxhimit të bankave;
- b) Departamenti i menaxhimit të hoteleri-turizmit;
- c) Departamenti i menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

3. FASTIP-i, gjatë periudhës kalimtare, e mbështet veprimtarinë në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në statut dhe në këtë vendim. Statuti i FASTIP-it, për periudhën kalimtare, miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. FASTIP-i ka mision të ofrojë arsimin universitar, të ciklit të parë dhe të dytë, të integruar me praktikën profesionale, drejtpërdrejt në sipërmarrje (arsimimi dual).

5. Detyrat kryesore të FASTIP-it janë:

a) Ofron arsimin universitar, të ciklit të parë dhe të dytë, të orientuar nga praktika profesionale, në kuadër të arsimit të lartë në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, duke pasur autonomi në të gjitha çështjet e arsimit të veçantë dual.

b) Përmblot detyrat, duke mbështetur personat, të cilët përfundojnë studimet, për të hyrë në jetën e punës, nëpërmjet bashkëveprimit me qendrat e trajnimit profesional të studentëve.

c) Qendrat e trajnimit profesional, në kuadër të këtij vendimi, janë sipërmarrje nga fusha e ekonomisë, institucione të krahasueshme jashtë fushës ekonomike, veçanërisht profesionet e lira, si dhe institucionet e partnerëve nga fusha sociale. Ata mund të marrin pjesë në arsimimin në kuadrin e FASTIP-it, në rast se janë në gjendje të ndërmjetësojnë përmbajtjet e përcaktuara arsimore.

ç) Studentët e FASTIP-it gëzojnë të njëjtat të drejta, si edhe studentët e fakulteteve të tjera.

d) FASTIP-i autorizohet të lidhë marrëveshje me shkollat e larta të huaja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për shkëmbimin e studentëve.

6. FASTIP-i ofron, duke filluar nga viti akademik 2008-2009, studime universitare, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, të cilat zgjasin 3 vite dhe mbyllen me diplomë të nivelit të parë (DNP) (Bachelor Degree), lëshuar nga UAMD-ja, në drejtimitet e mëposhtme:

- a) Menaxhimi i bankave;
- b) Menaxhimi i hoteleri-turizmit;
- c) Menaxhimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

7. Për vitin 2008-2009, numri i studentëve, që mund të pranohen në secilin drejtim, të ofruar nga FASTIP-i, është 30. Pranimi i tyre për këtë vit akademik bëhet sipas kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara nga FASTIP-i.

Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin akademik 2008-2009,

në njërën nga programet e studimit, që ofron FASTIP-i, është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

8. Organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese të FASTIP-it janë:

- a) Këshilli i fakultetit;
- b) Dekani;
- c) Dekanati.

9. Detyrat kryesore të këshillit të fakultetit janë, si më poshtë vijnë:

- a) Miraton statutin, rregulloret e veprimtarisë dhe planin afatgjatë të zhvillimit të fakultetit;
- b) Miraton strukturën dhe organikën e fakultetit;
- c) Miraton buxhetin, të ardhurat dhe shpenzimet e fakultetit;
- ç) Miraton planet mësimore dhe rregulloret përkatëse mësimore;
- d) Bën propozime për procesin mësimor, ndryshimin apo mbylljen e drejtimeve të studimeve

në fakultet;

dh) Miraton kriteret dhe procedurat e pranimeve të studentëve dhe të QTP-së, në fakultet;

e) Rregullon bashkëpunimin ndërmjet FASTIP-it dhe qendrave të trajnimit profesional, nëpërmjet:

- i) bashkërendimit të studimeve në FASTIP me formimin praktik në QTP;
- ii) planifikimit dhe sigurimit të kapaciteteve në FASTIP dhe të kapaciteteve në QTP, duke përcaktuar vëllimin e pjesëmarrjes së qendrave të veçanta të trajnimit profesional;
- iii) marrjes së masave për sigurimin e vendeve për formim profesional;
- iv) zbatimit të parimeve të kualifikimit për pranimin në QTP, si dhe hartimit të një liste me qendrat e përshtatshme për trajnimin profesional;
- v) rekomandimeve për pranimin e studentëve.

ë) Propozon përfaqësuesit e FASTIP-it në senatin dhe këshillin administrativ të universitetit;

f) Përzgjedh 3 kandidatura për dekan të fakultetit, të cilat ia dërgon, për emërim, rektorit të UAMD-së;

g) Harton raportin vjetor të veprimtarisë, duke përfshirë dhe veprimtarinë financiare dhe ia dërgon atë, për miratim, këshillit administrativ të universitetit, i cili, pas miratimit, ia dërgon për miratim, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

10. Këshilli i fakultetit kryesohet nga rektori i UAMD-së, ndërsa dekan i është zëvendëskryetar i këtij këshilli. Përbërja dhe funksionimi i këshillit të FASTIP-it përcaktohen në statutin e tij, duke mbajtur parasysh përfaqësimin e barabartë në numër të përfaqësuesve të biznesit, të përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të personelit akademik të FASTIP-it.

11. Dekanati është organ kolegjial ekzekutiv, që përbëhet nga:

- a) dekan;
- b) zëvendësdekan;
- c) kancelari i fakultetit.

11.1 Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit dhe përfaqësuesi ligjor i tij. Ai duhet të ketë, së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe, së paku, 3 vjet përvojë pune. Detyrat kryesore të dekanit përcaktohen në statutin e FASTIP-it.

11.2 Zëvendësdekan i mbështet dekanin në çështjen akademike të fakultetit. Ai mund të drejtojë edhe një departament të fakultetit. Ai duhet të ketë gradën shkencore “Doktor” dhe, së paku, 3 vjet përvojë pune.

11.3 Kancelari i fakultetit është përgjegjës për drejtimin e përditshëm administrativ dhe financiar të fakultetit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Kancelari i fakultetit duhet të ketë formim universitar juridik ose ekonomik dhe, së paku, 5 vjet përvojë pune.

12. Personeli akademik i FASTIP-it duhet të përmbushë kriteret, që parashikon ligji nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kriteret e tjera, që parashikon statuti i FASTIP-it.

13. Veprimtaria financiare dhe administrative e fakultetit realizohet nga dekan i FASTIP-it. FASTIP-i ka numër llogarie buxhetore të veçantë.

14. Niveli i pagave të punonjësve të FASTIP-it do të jetë i njëjtë me atë të personelit akademik respektiv në institucionet publike të arsimit të lartë. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen

sipas dispozitave të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Kodit të Punës.

15. FASTIP-i ka të drejtë të paguajë pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm, përtej nivelit të pagave, të përcaktuara në bazë të pikës 14 të këtij vendimi. Këto pagesa mund të bëhen nga të ardhurat e krijuara nga kontratat me sektorin privat ose në kuadër të projekteve të huaja, me destinacion të shprehur për këtë qëllim. Masa e pagesës për secilin rast përcaktohet nga këshilli i fakultetit.

16. FASTIP-i ka të drejtë të lidhë marrëveshje me institucione homologe ose personel akademik të huaj dhe të përballojë shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mësimdhënies nga fondet e fakultetit dhe nga financimet e donatorëve.

17. Struktura dhe organika e FASTIP-it miratohen nga këshilli i fakultetit, brenda numrit të punonjësve, të miratuar nga UAMD-ja.

18. FASTIP-i financohet nga Buxheti i Shtetit, i cili përfshihet brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe nga burime të tjera të ligjshme. FASTIP-i përfiton, në bazë të konkurrencës, nga programi i financimit shtetëror të projekteve për kërkim-zhvillim. Gjithashtu, mund të përfitojë financime edhe nga subjekte private, të interesuara për formimin universitar, kërkimin shkencor apo për ofrimin e shërbimeve, brenda fushave të veprimtarisë së saj.

19. Rektorati i UAMD-së siguron mjedise dhe pajisje, të cilat plotësojnë standardet e nevojshme për mësimdhënie, si dhe kushtet për akreditim.

20. FASTIP-i dhe diplomat e tij akreditohen brenda 3 vjetësh nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe nga një agjenci e europiane e njohur.

21. Gjatë periudhës kalimtare, FASTIP-i do të ketë varësi administrative nga UAMD-ja, që do të kontrollojë dhe auditojë përdorimin e fondeve buxhetore, zhvillimin e procesit të kërkimit dhe të gjithë ecurinë e fakultetit.

22. Aspektet e tjera të funksionimit të FASTIP-it, gjatë periudhës kalimtare, të cilat nuk janë përmendur në këtë vendim, rregullohen në bazë të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe statutit të FASTIP-it.

23. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të parashikuara për mbulimin e pagave, sigurimet shoqërore, shpenzimet për blerje materiale e shërbimesh, si dhe fondet për investime, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

24. Në fund të periudhës kalimtare, Ministri i Arsimit dhe Shkencës propozon akte të mëtejshme nënligjore, për funksionimin e mëtejshëm të FASTIP-it.

25. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.828, datë 4.6.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 65 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

RREGULLORE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

1. Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës rregullon veprimtarinë e tij mbështetur në këtë rregullore e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe që përcakton kompetencat, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, që më pas në tekst do të quhet Këshilli, si dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij.

2. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH-i) mund të përgatisë edhe rregullore të funksionimit të tij të brendshëm apo për koordinimin e veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore, por brenda kompetencave dhe fushave të veprimtarisë së tij.

3. Veprimtaria e Këshillit ushtrohet në përputhje me këtë rregullore, e cila ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik për veprimtarinë e tij.

Neni 2

Funksioni i Kryetarit të Këshillit

1. Kryetari i Këshillit thërret mbledhjet dhe i drejton ato, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, koordinon punën, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. Ai merr në konsideratë vendimet e marra përgjatë mbledhjeve të Këshillit, si dhe të orientimeve programore, kur ato janë marrë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, pavarësisht vlerësimit të tij individual.

2. Kryetari cakton ndërmjet anëtarëve të zgjedhur të Këshillit një zëvendës, me funksion zëvendësimit në rast mungese të tij ose në rast delegimi të drejtimit të Këshillit.

Neni 3

Funksioni dhe detyrat e Këshillit

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit në arsimin e lartë, kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik në vend.

2. Këshilli formulon mendime dhe propozime lidhur me:

a) hartimin e strategjive e programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimit e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;

b) fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik;

c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;

ç) standardet për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve;

d) kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore, së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë;

dh) zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre;

e) çdo problem tjetër që kërkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 4

Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të Këshillit
dhe sekretariati teknik

1. Përbërja e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës është sipas përcaktimeve në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007. Ai ka në përbërje 19 anëtarë, ndër të cilët 15 anëtarë janë ekspertë të fushave

të ndryshme të shkencës, të zgjedhur me konkurrim publik, si dhe disa anëtarë të tjerë, ekspertë për shkak të funksioneve.

2. Anëtarët ekspertë në Këshill zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Ndërkohë në Këshill 15 anëtarët ekspertë të zgjedhur me konkurrim publik i nënshtrohen një mandati me rotacion, ku pesë anëtarë të tij do të kenë mandat 3-vjeçar dhe pesë anëtarë të tjerë do të kenë një mandat 5-vjeçar. Përcaktimi i tyre do të bëhet me short, i cili do të hidhet respektivisht në përfundim të periudhës 3-vjeçare dhe asaj 5-vjeçare.

3. Në vijim mandati i anëtarëve të këtij Këshilli do të jetë 7-vjeçar.

4. Këshilli mbështetet me sekretariat teknik, i cili koordinon veprimtarinë e Këshillit me atë të Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Drejtorinë e Kërkimit Shkencor në MASH, vë në dispozicion të Këshillit materiale dhe dokumente lidhur me çështje brenda kompetencave të drejtorisë, të cilat do trajtohen në Këshill, kërkon gjithashtu ndimën e Këshillit edhe për çështje të brendshme të drejtorisë, të cilat përputhen me detyrat dhe misionin e Këshillit. Sekretariati përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e Këshillit në formën e kërkuar për ekzekutim dhe ia paraqet ato ministrit. Në sekretariatit e Këshillit marrin pjesë Zëvendësministri për Arsimin e Lartë në MASH, i cili njëkohësisht koordinon edhe të gjithë punën e këtij sekretariati, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë, Drejtori i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Drejtori i Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë, si dhe një jurist.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës mund të përcaktojë edhe përbërje ndryshe të sekretariatit teknik. Sekretariati ka gjithashtu brenda tij edhe një ose dy sekretarë, të cilët mbajnë procesverbalet e zhvillimit të mbledhjeve, fotokopjojnë materialet që do të shpërndahen për mbledhje, mbajnë korespondenca lidhur me njoftime të ndryshme të anëtarëve të Këshillit, si dhe shërbime të tjera.

5. Përbërja nominative e sekretariatit teknik, detyra të tjera dhe pagesa e tyre caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 5

Komisionet, komitetet dhe grupet e punës së këshillit

1. Këshilli, me qëllim realizimin e misionit dhe detyrave të tij, ndahet në komisione të përhershme dhe në komitete të fushave disiplinore. Ai mund të ngrejë gjithashtu grupe të përkohshme pune për studimin e çështjeve a problematikave të veçanta.

2. Anëtarët e komisioneve të përhershme, e komiteteve të fushave disiplinore dhe grupeve të përkohshme të punës zgjedhin ndërmjet tyre koordinatorët/kryetarët të cilët drejtojnë mbledhjet dhe organizojnë punën në grupet përkatëse.

3. Kryetari i Këshillit mund të thërrasë një ose më shumë komisione, komitete ose grupe të përkohshme pune në mbledhje të përbashkëta.

4. Veprimtaria e komisioneve, e komiteteve dhe e grupeve të përkohshme të punës nuk mund të zhvillohen në të njëjtën kohë me mbledhjet e Këshillit.

5. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të asistojë dhe të japë mendimin e tij në mbledhjet e komisioneve e komiteteve ose të grupeve të punës, në të cilat nuk është anëtar.

Neni 6

Komisionet e përhershme

1. Këshilli ngre, në bazë edhe të përbërjes së tij, komisionet e përhershme të punës, të cilat janë:

- a) Komisioni i strategjive dhe politikave të arsimit të lartë dhe shkencës;
- b) Komisioni i vlerësimit të cilësisë dhe organizimit të studimeve në arsimin e lartë;
- c) Komisioni i buxhetit dhe autonomisë universitare;

2. Komisionet mund të kenë edhe fusha të tjera nëndisiplinore nën kompetencën e tyre. Këto fusha propozohen në mbledhjen e Këshillit duke u miratuar me shumicë të thjeshtë votash dhe caktohen më pas me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Çdo anëtar i Këshillit merr pjesë vetëm në një komision të përhershëm.

4. Komisionet zhvillojnë detyra studimi, dokumentimi dhe propozimi për tema të interesit të përgjithshëm sipas fushave përkatëse, të cilat relatohen në mbledhjen e Këshillit.

Neni 7

Komitetet e fushave disiplinore

1. Këshilli ngre në bazë, të përbërjes së tij, komitetet e fushave disiplinore të mëposhtme:
 - a) shkencat e natyrës;
 - b) shkencat mjekësore;
 - c) shkencat agrare e veterinare;
 - d) shkencat inxhinierike;
 - e) shkencat e informatikës dhe teknologjive të informacionit;
 - f) shkencat filologjiko-letrare, politike dhe sociale;
 - g) shkencat juridike, ekonomike dhe statistike;
 - h) shkencat e edukimit.
2. Çdo komitet përbëhet nga tre anëtarë. Në përbërje të komiteteve të fushave disiplinore mund të marrin pjesë edhe ekspertë të jashtëm jo anëtarë të Këshillit për periudha të përcaktuara, të thirrur nga Kryetari. Koordinator i secilit komitet është anëtar i Këshillit, sipas fushave respektive të njëjta ose të përafërta disiplinore.
3. Për çështje specifike apo të karakterit ndërdisiplinor, komitetet e fushave disiplinore mund të veprojnë së bashku, me propozim të shumicës së anëtarëve të çdo komiteti dhe miratim të Kryetarit.
4. Komitetet zhvillojnë detyra srudimi, dokumentimi dhe propozimi për probleme të fushave disiplinore përkatëse, të cilat relatohen në mbledhjen e Këshillit.

Neni 8

Grupet e përkohshme të punës

1. Për trajtimin e temave specifike, Këshilli mund të thërrasë edhe grupe të përkohshme pune me përbërje deri në 3 ekspertë të jashtëm, si dhe 1 ose 2 nga anëtarët e Këshillit, ekspertë të asaj fushe. Grupet krijohen nga kryetari me konsensus edhe të shumicës së anëtarëve të këshillit.
2. Grupet e përkohshme të punës të Këshillit funksionojnë për periudha të caktuara dhe shqyrtojnë apo japin mendime a qëndrime të ndryshme lidhur me fusha specifike, të veçanta apo që kërkojnë mendime më të specializuara. Këto grupe pune i marrin detyrat nga Kryetari, i cili i ka diskutuar më parë në mbledhjen e këshillit.
3. Detyrat e grupeve të përkohshme të punës prezantohen në mbledhjet e Këshillit dhe materiali i paraqitur shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit, ku ky miraton materialin e propozuar me shumicë votash, ose e refuzon atë për përdorim. Në çdo rast materiali ruhet në arshivën e materialeve të Këshillit.

Neni 9

Funksionet e relatorëve

1. Komisionet e përhershme të Këshillit, komitetet e fushave disiplinore dhe grupet e përkohshme të punës caktojnë nga një relator ndërmjet anëtarëve të tyre, për t'i relatuar Këshillit në lidhje me çështjet përkatëse të trajtuara prej tyre.
2. Kryetari mund t'u ngarkojë drejtpërdrejt komisioneve të përhershme, komiteteve të fushave disiplinore ose grupeve të përkohshme të punës çështje të veçanta për shqyrtim. Në këtë rast, relatori përkatës përgatit relacionin për ta paraqitur atë në mbledhjen e Këshillit.
3. Relatorët paraqesin në mbledhjen e Këshillit tekstin e dokumentit apo punimit që do të diskutohet, i cili iu bëhet i njohur të gjithë anëtarëve të Këshillit nëpërmjet Sekretarit, duke zbatuar procedurat e përmendura në këtë rregullore.
4. Në përfundim, propozimet e mësipërme miratohen me shumicën e thjeshtë të votave.

Neni 10

Mbledhjet e Këshillit

1. Këshilli mbledhet mbi bazën e një kalendari semestral. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe.
2. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar nga

Sekretari, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime.

3. Mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit.

Neni 11

Mbledhjet e jashtëzakonshme

Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me kërkesë të Kryetarit ose me kërkesë me shkrim të 1/3 së anëtarëve të Këshillit.

Neni 12

Thirrja e mbledhjeve të Këshillit

1. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen nëpërmjet postës elektronike, të paktën 3 ditë para datës së thirrjes së mbledhjes, si dhe njoftimeve nëpërmjet telefonit. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme bëhen duke respektuar të njëjtën procedurë, të paktën 1 ditë para datës së thirrjes së mbledhjes.

2. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje do të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

Neni 13

Rendi i ditës

1. Kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës mund të përfshijë çështje të propozuara nga komisionet apo nga të paktën 5 anëtarë të Këshillit. Rendi i ditës mund të përfshijë edhe relitime të problemeve të veçanta për shqyrtim, të ngarkuara nga Kryetari drejtpërdrejt komisioneve të përhershme, komiteteve të fushave disiplinore ose grupeve të përkohshme të punës.

2. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 ditë para datës së vendosur për mbledhjen.

3. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, nëpërmjet postës elektronike, të paktën 3 ditë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.

4. Në fillim të mbledhjes, me kërkesë të Kryetarit ose të paktën 10 anëtarëve të Këshillit, mund të propozohen shtesa në rendin e ditës, të cilat duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të Këshillit të pranishëm në mbledhje. Nëse trajtimi i çështjeve shtesë kërkon parapërgatitje, seanca shtyhet me 24 orë.

Neni 14

Marrja e vendimeve

Këshilli merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës ose për çështje shtesë të rendit të ditës të miratuara paraprakisht si pjesë e rendit të ditës.

Neni 15

Diskutimet

1. Diskutimet mund të zgjasin deri në 20 minuta kur u referohen argumenteve të karakterit të përgjithshëm, ose 15 minuta kur u referohen praktikave të veçanta ose grupe praktikash, replikat eventuale nuk mund të kalojnë 3 minuta.

2. Relatimet, diskutimet për çështje prioritare ose tema të tjera të një rëndësie të veçantë të kërkuara nga vetë Kryetari, jashtë diskutimeve normale, nuk janë pjesë e përcaktimeve të bëra në paragrafin e parë të kësaj pike.

Neni 16

Votimi i detyrueshëm

Anëtarët e Këshillit që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore

për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Kryetari i Këshillit voton në fund.

Neni 17 **Forma e votimit**

1. Votimet zhvillohen në mënyrë të hapur. Me kërkesën e të paktën 5 anëtarëve të Këshillit, formuluar në përfundim të diskutimeve ose me iniciativë të Kryetarit, votimi bëhet me apel nominal sipas rendit alfabetik, ose i fshehtë.

2. Modalitetet e votimit të fshehtë përcaktohen me rregulla të brendshme.

3. Kur votimi lidhet me propozimin e personave joanëtarë të Këshillit në pozicione me rëndësi të veçantë, ky vendim merret me votim të fshehtë dhe pa debat. Profili shkencor i kandidatit të propozuar prezantohet nga një anëtar i Këshillit dhe materiali respektiv iu shpërndahet të gjithë anëtarëve të tij duke zbatuar procedurat e përmendura në rregullore.

Neni 18 **Shumica e nevojshme për të marrë vendime dhe barazia e votave**

1. Votimi në Këshill quhet i rregullt kur në të marrin pjesë të paktën 50%+1 e anëtarëve të Këshillit.

2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, ky do të quhet votim me shumicë të thjeshtë.

3. Asnjë anëtar i Këshillit nuk mund të marrë pjesë në votimin që bëhet për çështje që lidhen me të personalisht apo familjarë e të afërm të tij, në bazë të ligjit “Për konfliktin e interesit”.

4. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e Kryetarit është vendimtare.

Neni 19 **Procesverbali i mbledhjes**

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje në formë sintetike e gjithçkaje që u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

2. Anëtarët e Këshillit mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Këshilli.

3. Procesverbali i çdo mbledhjeje të Këshillit redaktohet në formë sintetike nga sekretari që mban procesverbalin gjatë mbledhjeve, nën mbikëqyrjen e Sekretariatit teknik.

4. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të regjistrojë në procesverbal mosaprovimin e tij ose mendimin kundër mbi argumente të veçanta, si dhe të kërkojë përfshirjen e një deklarimi të bërë prej tij gjatë mbledhjes, të cilin e përgatit me shkrim.

5. Secili nga anëtarët e Këshillit mund të kërkojë të shohë procesverbalin e mbajtur. Ai duhet të pasqyrojë qartë dhe me transparencë atë çka ndodh në mbledhje, duke pasqyruar edhe mendimet pro apo kundër të anëtarëve të Këshillit.

6. Procesverbali mbahet nën përgjegjësinë e sekretariatit dhe është i disponueshëm në sekretari. Ai duhet të firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse, duke konfirmuar kështu edhe pjesëmarrjen e tyre.

Neni 20 **Informimi i publikut**

1. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës hapet një faqe e veçantë për veprimtarinë e Këshillit.

2. Sekretariati teknik i KALSH-it merr masat për hapjen e një rubrike të veçantë në faqen zyrtare të internetit të ministrisë. Ai përgatit dhe publikon, në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, të gjitha informacionet e që mund të bëhen publike. Para publikimit merret miratimi i kryetarit të Këshillit.

Neni 21
Ndryshimet e rregullores

Propozimi për ndryshim të rregullores së veprimtarisë së Këshillit miratohet me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

Neni 22
Dokumentacioni

Këshilli ruan të gjitha dokumentet, informacionet, raportet, studimet a materiale të tjera të paraqitura në formën zyrtare në mbledhjet e Këshillit. Këto materiale ruhen pranë drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë në MASH nën përgjegjësinë e Sekretariatit teknik dhe në fund të çdo viti kalendarik depozitohen në protokollin e ministrisë në një dosje me mbishkrimin “Materiale të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës”. Këshilli ruan gjithashtu të gjitha procesverbalet e mbajtura për zhvillimin e mbledhjeve të tij në formën e përshkruar më sipër.

VENDIM
Nr.829, datë 4.6.2008

PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “SHKOLLA E LARTË EUROPIANE PËR TURIZMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin” do të organizohet në dy fakultete, si më poshtë vijon:
 - a) Fakulteti i Turizmit, i cili do të ofrojë:
 - programe studimi, të ciklit të parë, në:
 - i) ekonominë e turizmit, me drejtimet ekonomi turizmi dhe politikat e turizmit;
 - ii) administrim të shërbimeve turistike, me drejtimet restoranteri dhe hotelieri.
 - programe studimi “Master i nivelit të parë” (MNP) në:
 - i) hotelieri;
 - ii) turizëm.
 - b) Fakulteti i Shkencave të Teknologjisë Informatike dhe Komunikimit, i cili do të ofrojë:
 - programe studimi, të ciklit të parë, në:
 - i) teknologji dhe informacion;
 - ii) komunikim dhe gjuhë biznesi.
 - programe studimi “Master i nivelit të parë” (MNP) në:
 - i) teknologji informacioni dhe komunikimi.
3. Programet e studimeve, që organizohen pranë institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin”, janë me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit, të ciklit të parë, është 3 vjet dhe kohëzgjatja normale e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” është 1 vit.
4. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit, të ciklit të parë, lëshohet “Diploma e

nivelit të parë” (DNP), përkatësisht:

- a) në turizëm, me drejtim ekonomia e turizmit;
- b) në turizëm, me drejtim politikat e turizmit;
- c) në administrim të shërbimeve turistike, me drejtim restoranti;
- ç) administrim të shërbimeve turistike, me drejtim hoteleri;
- d) në teknologji dhe informacion;
- dh) në komunikim dhe gjuhë biznesi.

5. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, lëshohet diploma “Master i nivelit të parë” (MNP), përkatësisht:

- a) në hoteleri;
- b) në turizëm;
- c) në teknologji informacioni dhe komunikimi.

6. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin për këtë qëllim.

8. Ndryshime në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe elementet e tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.830, datë 4.6.2008

PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË
“SHKOLLA E LARTË “NEHEMIA””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia””, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Pogradecit.

2. “Shkolla e Lartë “Nehemia”” do të organizohet në dy fakultete, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë, i cili do të ofrojë programe studimi, të ciklit të parë, në:

- i) statistikë dhe matematikë;
 - ii) shkenca kompjuterike;
 - iii) biznes dhe ekonomi.
- b) Fakulteti i Shkencave Humane, i cili do të ofrojë:

- programe studimi, të ciklit të parë, në:

- i) gazetari;
- ii) gjuhë moderne;
- iii) edukim dhe etikë.

- programe studimi, të ciklit të dytë, në:

- i) lidërsip dhe vlerësim arsimor;
- ii) studime europiane.

3. Programet e studimeve, që organizohen pranë këtij institucioni, janë me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të parë është 3 vjet dhe kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë, është 2 vjet.

4. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit të ciklit të parë lëshohet “Diploma e nivelit të parë” (DNP), përkatësisht:

- a) në statistikë të zbatuar;
- b) në matematikë;
- c) në sistemet e informimit kompjuterik;
- ç) në biznes dhe ekonomik;
- d) në gazetari;
- dh) në anglisht;
- e) në gjermanisht;
- ë) në studime fetare dhe të etikës.

5. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit të ciklit të dytë lëshohet “Diploma e nivelit të dytë” (DND), përkatësisht:

- a) në lidërsip dhe vlerësim arsimor;
- b) në studime europiane.

6. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia””, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia”” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin për këtë qëllim.

8. Ndryshime në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe elementet e tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia”” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.831, datë 4.6.2008

PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Arsimit

dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programeve të studimit, të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë, “Filozofi” e “Sociologji”.

2. Hapjen pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të programit të studimit, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, “Gjuhë spanjolle”.

3. Kohëzgjatja e secilit program do të jetë 3 vjet, me 180 kredite. Në përfundim të secilit program studimi lëshohen, përkatësisht, “Diplomë e nivelit të parë, në filozofi”, “Diplomë e nivelit të parë, në sociologji” dhe “Diplomë e nivelit të parë, në gjuhë spanjolle, me drejtim gjuhë-letërsi dhe qytetërim hispanik”.

4. Mbylljen pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programit të studimit “Filozofi-Sociologji”.

5. Studentët e regjistruar në programin e studimit “Filozofi-Sociologji”, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do t’i vazhdojnë studimet në këtë program për kohëzgjatjen normale të tij.

Studentët mbetës do të marrin një diplomë, në varësi të afateve të studimeve të tyre dhe të programit të studimit, të ciklit të parë, “Filozofi” ose “Sociologji”, të përzgjedhur prej tyre.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i viti 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.832, datë 4.6.2008

PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, të programeve të studimit, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, “Informatikë”, “Matematikë”, me dy drejtime, “Matematikë” dhe “Matematikë-Fizikë”, dhe “Inxhinieri mekanike”, me dy drejtime, “Inxhinieri mekanike” e “Inxhinieri navale”.

2. Kohëzgjatja e secilit program do të jetë 3 vjet, me 180 kredite. Në përfundim të secilit program studimi lëshohen, përkatësisht, “Diplomë e nivelit të parë, në Informatikë”, “Diplomë e nivelit të parë, në Matematikë”, “Diplomë e nivelit të parë në Matematikë-Fizikë”, “Diplomë e nivelit të parë në Inxhinieri Mekanike” dhe “Diplomë e nivelit të parë në Inxhinieri Navale”.

3. Mbylljen, pranë universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, të programit të studimit “Inxhinieri Navale”.

4. Mbylljen, pranë universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Edukimit, të programit të studimit “Matematikë-Fizikë”.

5. Studentët e regjistruar në programet e studimeve “Inxhinieri Navale” dhe “Matematikë-

Fizikë”, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do t’i vazhdojnë studimet në këto programe studimi, për kohëzgjatjen normale të tyre. Studentët mbetës në këto programe studimi do të marrin diplomën, në varësi të afateve të studimeve të kryera.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.833, datë 4.6.2008

**PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË,
NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI” KORÇË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të studimit, të ciklit të parë, në formën studimore me kohë të plotë, “Matematikë-Fizikë” dhe “Matematikë-Informatikë”.

2. Kohëzgjatja e secilit program do të jetë 3 vjet, me 180 kredite. Në përfundim të secilit program studimi lëshohen, përkatësisht, “Diplomë e nivelit të parë në Matematikë-Fizikë” dhe “Diplomë e nivelit të parë në Matematikë-Informatikë”.

3. Mbylljen, pranë universitetit “Fan S. Noli” Korçë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programit të studimit “Matematikë”.

4. Studentët e regjistruar në programin e studimit “Matematikë”, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do t’i vazhdojnë studimet në këtë program studimi për kohëzgjatjen normale të tij.

Studentët mbetës do të marrin një diplomë në varësi të afateve të studimeve të kryera dhe programit të studimit të ciklit të parë “Matematikë-Fizikë” ose “Matematikë-Informatikë”, të përzgjedhur prej tyre.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.834, datë 11.6.2008

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 20 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të

Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “a” të pikës 5 të vendimit nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kur familjarit të autorizuar, sipas listës dhe vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, i ndërpritet shpërblimi, si rezultat i ndryshimit të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, kjo e drejtë i kalon njërit prej pjesëtarëve të trungut familjar, të përcaktuar në përputhje me ligjin e sipërpërmendur, i cili paraqet, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, certifikatën e trungut familjar dhe prokurën e lëshuar nga përfituesit e tjerë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.835, datë 11.6.2008

PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË AKSIONEVE TË KAPITALIT, TË SHOQËRISË ANONIME “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”, QË U OFROHET INVESTITORËVE STRATEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 3, 7, 8 e 9 të ligjit nr.9889, datë 20.3.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Madhësia e paketës së aksioneve të kapitalit, të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, (OSSH), që u ofrohet investitorëve strategjikë, të jetë 76 për qind.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të realizojë tenderin për privatizimin e shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, sipas kërkesave të përcaktuara në tekstin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

INSTRUKSIONE

PER REALIZIMIN E TENDERIT PER PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES”, SHA

Ministria e Ekonomisë, Tregtise dhe Energjetikes e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 3, 7 dhe 9 të Ligjit Nr.9889, datë 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit te Shperndarjes” (“OSSH”) dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar, ka hartuar procedurat per perzgjedhjen e investitoreve strategjike, te interesuar per blerjen e aksioneve te shoqerise anonime OSSH.

1 HYRJE

Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme në sektorin energjetik, me qëllim liberalizimin dhe zhvillimin e tregut Shqiptar të energjisë elektrike. Një numër masash janë marrë në mënyrë që kjo reforma të implementohet nëpërmjet vendosjes së një tregu energjitik kompetitiv, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian, duke përfshirë rishikimin e KESH-it dhe tërheqjen e investitorëve strategjike në këtë sektor me anë të privatizimit.

Ministria e Ekonomisë, Tregtise dhe Energjetikes (METE) e Republikës së Shqipërisë dëshiron të privatizojë shoqëri anonime Operatori i Sistemit të Shperndarjes SHA (“OSSH”), me seli në Rrugen “Vasil Shanto” Tiranë, Shqipëri. OSSH merret me shperndarjen e energjisë. Privatizimi i OSSH do të realizohet nëpërmjet shitjes së 76% të aksioneve të OSSH të mbajtura nga METE, tek një investitor strategjik (“Projekti”). Me qëllim që të tërhiqet investitori më optimal strategjik për të operuar dhe zhvilluar OSSH, METE ka vendosur të ndërmarrë një proces të hapur ndërkombëtar tenderimi (“Proçesi i Tenderimit”) për ekzekutimin dhe përfundimin e një marrëveshjeje të blerjes së aksioneve (“Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve”) që do të nënshkruhet ndërmjet METE dhe investitorit strategjik.

1.1. Ofertuesit

Ftesa për Tender nga METE si dhe udhëzimet për ofertuesit u adresohen vetëm Ofertuesve të Parakualifikuar, të cilët mund të jenë subjekte ligjore të huaja apo lokale (“Ofertuesit”). Për sqarim, Ofertuesit e paparakualifikuar dhe Ofertuesit e Parakualifikuar që e kanë humbur statusin si Ofertues të Parakualifikuar nuk kanë të drejtën të dorëzojnë një Ofertë.

1.2. Kostot

Ofertuesi do të përballojë të gjithë kostot e lidhura me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij dhe me pjesëmarrjen e Ofertuesit në Proçesin e Tenderit (“Kostot e Tenderit”) duke përfshirë, pa kufizim, të gjithë kostot dhe shpenzimet e lidhura me përfshirjen e Ofertuesit në:

- mbledhjen e informacionit;
- intervistat;
- përgatitjen e përgjigjeve ndaj pyetjeve apo kërkesave për sqarim nga METE;

- përgatitjen e pyetjeve të Ofertuesve gjatë procesit të qartësimit; dhe
- diskutimet e Marrëveshje së Blerjes së Aksioneve.

METE nuk do të jetë përgjegjëse për pagesën e asnjë nga Kostot e Tenderit për asnjë Ofertues, pavarësisht nga administrimi apo rezultati i Procesit të Tenderimit.

Ofertuesi i Tenderit (sic percaktohet në Seksionin 5.8) do të perballojë të gjithë kostot e lidhura me përgatitjen e dokumentacionit dhe publikimin e fteses për Parakualifikim dhe Fteses për Tender.

1.3. Rregullat e përgjithshme të procesit të tenderit

Kuadri Ligjor:

Proçesi i Tenderimit do të administrohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe kushtet e percaktuara në këto shtojce.

Gjuha:

Oferta teknike dhe ajo financiare ("Oferta") e dorëzuar nga Ofertuesi, si dhe çdo korrespondence dhe dokumenta në lidhje me Oferten duhet të dorëzohen në Anglisht, me përjashtim të broshurave dhe literaturave të para-printuara, të cilat mund të jenë në një gjuhë tjetër, nëse shoqërohen me një përkthim të certifikuar në Anglisht.

Pranimi i Kushteve të Procesit të Tenderimit:

Dorëzimi i Ofertes nga Ofertuesi kërkon njohje të plote dhe pranim të tërësive kushteve të percaktuara në udhëzimet për ofertuesit, si dhe të të gjitha detyrimeve nëse shpallet Ofertuesi Fitues (sic percaktohet në Seksionin 5.8)

1.4. Kufizime në Pjesëmarrje

Çdo Ofertues mund të dorëzojë vetëm një Ofertë dhe çdo kompani mund të marrë pjesë në Proçesin e Tenderimit vetëm nëpërmjet një Oferte. Një kompani konsiderohet që merr pjesë në Proçesin e Tenderimit në rastet kur:

- është një Ofertues dhe dorëzon një Ofertë; ose
- ka kontroll mbi një nga Ofertuesit që dorëzon një Ofertë.

"Kontroll" do të thotë kontroll në çdo mënyrë, që ka si rezultat kontrollin faktik, drejtpërdrejt nëpërmjet pronësisë së aksioneve të investimit ose tërthorazi nëpërmjet një trusti, një kontrate, pronësisë së aksioneve të investimit të çdo korporate tjetër ose mënyrë tjetër.

Asnjë Ofertues apo anëtar i një bashkimi të perkohshëm shoqërorish nuk mund të paraqesë ofertë, nëse një nga këshilltarët apo konsulentët e jashtëm të METE-s ka aksione tek Ofertuesi apo tek një nga anëtarët e bashkimit të perkohshëm të shoqërive.

2. DOKUMENTAT E TENDERIT

2.1. Permbajtja e Dokumentave te Tenderit

2.1.1 Ne dokumentat e tenderit perfshihen dokumentat si me poshte:

- Ligji për Privatizimin e OSSH
- Vendimi i Këshillit të Ministrave per Tenderin
- Urdhri i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës
- Çertifikata e regjistrimit të OSSH në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive
- Akti i Themelimit të OSSH
- Bilanci i çertifikuar i OSSH në fund të vitit 2007
- Kopje të raporteve zyrtare për OSSH nga eksperti kontabel i autorizuar i OSSH
- Memorandumi i Informimit mbi Projektin
- Marrëveshja e Konfidencialitetit
- Projekt-marrëveshja e Blerjes së Aksioneve
- Formulari i Ofertes Teknike
- Formulari i Ofertës Financiare
- Formulari i Aplikimit të Ofertës;
- Formulari i Sigurimit te Ofertes
- Formulari i konfirmimit te kushteve minimale te detyrueshme te performances teknike.
- Prokura.

2.1.2 Çdo Ofertues do të shqyrtojë të gjithë udhëzimet, kushtet, formularët, specifikimet dhe informacionet e tjera të përfshira në Dokumentet e Tenderit. Nëse Ofertuesi:

- a) nuk dorëzon të gjithë dokumentacionin dhe informacionet e kërkuara nga Dokumentet e Tenderit; ose
- b) dorëzon një Ofertë e cila nuk është në thelb në përputhje me kushtet e Dokumentave të Tenderit,

ky veprim është një rrezik për Ofertuesit dhe METE mund të deklarojë Ofertën si jo në përputhje me Dokumentat e Tenderit dhe ta refuzojë atë.

2.1.3 Dokumentat e Tenderit do të lëshohen për secilin nga Ofertuesit që ka nënshkruar Marrëveshjen e Konfidencialitetit.

2.2 Qartësimi i Dokumentave të Tenderit

2.2.1 Një Ofertues që kërkon sqarim apo modifikim të Dokumentave të Tenderit mund të njoftojë METE-n me e-mail në adresën **dkraja@mete.gov.al**, me një kopje për Drejtuesin e Ekipit të Projektit të IFC. Gjithashtu nëse Ofertuesi mendon që ndonjë dispozitë e Dokumenteve të Tenderit është e papranueshme, një çështje e tillë mund të ngrihet në çdo moment përpara Afatit të Dorëzimit të Ofertave të specifikuar në Kalendarin e Parashikuar (siç përcaktohet në Seksionin 2.5.1) pa pasojë për të drejtën vetëgjykmorë të METE-s për të miratuar apo refuzuar këto ndryshime.

2.2.2 Çdo kërkesë për qartësim apo modifikim të Dokumentave të Tenderit duhet të merret (në mënyrën e specifikuar në Seksionin 2.2.1 jo më vonë se data e përcaktuar në Kalendarin e Parashikuar. Kopje elektronike të përgjigjes (nëse ka), përfshirë një shpjegim të kërkesës, por jo një identifikim të burimit të saj ("**Dokumenti i Përgjigjes ndaj Pyetjeve**"), do t'i dërgohet nga METE (apo një person i autorizuar nga METE) secilit Ofertues që ka blerë Dokumentat e Tenderit. Nëse Ofertuesit bëjnë pyetje të ngjashme apo të përsëritura, këto pyetje do të renditen si një pyetje dhe METE mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje vetëm një herë. Asnjë Dokument i Përgjigjes ndaj Pyetjeve dhe/ose informacion i dhënë me gojë apo me shkrim do të jetë detyrues për ndonjë palë. Vetëm Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve dhe shtojcat e saj, kur të zbatohet siç duhet, do të ketë forcë ligjore dhe do të jetë detyrues për palët.

2.2.3 Do të ketë dy (2) raunde komentesh në mënyrë që Ofertuesit të paraqesin dhe diskutojnë me METE-n komentet e tyre me shkrim mbi Udhëzimet për Ofertuesit, përfshirë dhe Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve.

2.3 Amendimi i Dokumenteve të Tenderit

2.3.1 Në çdo moment përpara Afatit të Dorëzimit të Ofertave, ose pas Afatit të Dorëzimit të Ofertave, në lidhje me një ndryshim në Kalendarin e Parashikuar, METE mund të ndryshojë, për çdo arsye, qoftë me iniciativën e saj qoftë në përgjigje të një sqarimi të kërkuar nga një Ofertues, Dokumentat e Tenderit me anë të një amendimi. Asnjë lloj komunikimi tjetër përfshi, pa kufizim, edhe Dokumentin e Përgjigjeve ndaj Pyetjeve, nuk do të modifikojë Dokumentat e Tenderit.

2.3.2 Amendimi do t'u njoftohet me shkrim të gjithë Ofertuesve dhe dokumentet e amenduara do të jete dokumentacioni i zbatueshëm për qëllimet e Proçesit të Tenderimit.

2.3.3 Me qëllim që t'u jepet Ofertuesve kohë e arsyeshme gjatë së cilës të marrin parasysh amendimin në përgatitjen e Ofertave të tyre, METE mund të shtyjë, sipas vetëgjykimit të saj, Afatin e Dorëzimit të Ofertave, rast në të cilin, METE do të njoftojë me shkrim të gjithë Ofertuesit rreth afatit të shtyrë.

2.4 Informacion i dhënë nga Autoritetet/ Due Diligenc-a e Ofertuesve

2.4.1 Secili Ofertues është përgjegjës vetë për kryerjen e kërkimeve të tij, due diligence, dhe çdo punë apo hetim tjetër i pavarur dhe për të kërkuar çdo konsulencë tjetër të pavarur që është e nevojshme, me shpenzimet e tij, për përgatitjen e Ofertës, negociatat dhe finalizimin e Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve.

2.4.2 Nuk bëhet asnjë përfaqësim apo garanci, e shprehur apo nënkuptuar, dhe nuk pranohet asnjë lloj përgjegjësie nga METE dhe personeli dhe agjentët e saj ("Autoritetet") apo këshilltarët, punonjësit, konsulentët ose agjentët, për plotësinë e dokumentacionit apo saktësinë e çdo informacioni që është dhënë në Dokumentat e Tenderit apo Dokumentin e Përgjigjes ndaj Pyetjeve, apo të dhënë gjatë Proçesit të Tenderimit apo negociatave të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve. Autoritetet dhe këshilltarët, punonjësit, konsulentët ose agjentët e tyre nuk do të kenë detyrime ndaj asnjë personi apo enti si rezultat i përdorimit të ndonjë informacioni që përmbahet në Dokumentet e Tenderit apo në Dokumentin e Përgjigjes ndaj Pyetjeve, apo të dhënë gjatë Proçesit të Tenderimit apo negociatave dhe përmbylljes së Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve.

2.4.3 Ofertuesit nuk do të mbështeten në asnjë deklaratë verbale të bërë nga Autoritetet apo këshilltarët, punonjësit, konsulentët ose agjentët e tyre.

2.4.4. Të gjithë Ofertuesit do të shqyrtojnë, përpara dorëzimit të Ofertës së tyre, të gjithë kërkesat në lidhje me respektimin e regjistrimit juridik dhe të gjithë kërkesave që zbatohen për kompanitë që dëshirojnë të kryejnë biznes në Shqipëri. Ofertuesit janë vetë përgjegjës për të gjithë çështjet që lidhen me aftësinë e tyre ligjore për të operuar në fushën për të cilën zbatohet ky Proçes Tenderimi.

2.4.5. Çdo informacion, i dhënë nga Autoritetet gjatë "due diligence"-s, do të jetë subjekt i Marrëveshjes së Konfidencialitetit të nënshkruar nga të gjithë Ofertuesit.

2.5 Afatet Kohore të Planit të Punes

2.5.1 Nje Plan kohor per Proçesin e Tenderit do te perfshihet ne Instruksionet per Ofertuesit ("Plani i Afateve Kohore").

2.5.2 METE ka te drejte, qe kur e gjykon te nevojshme, pa njoftuar paraprakisht Ofertuesit, te ndryshoje Planin e Afateve Kohore. Ofertuesi nuk duhet, ne asnje menyre, te bazohet ne kete Plan te Afateve Kohore te parashikuar dhe METE nuk do te kete asnje detyrim ne rast ndryshimi te ketij Plani. METE, sidoqoftë, duhet te njoftojë Ofertuesit per ndryshimet e mundshme ne kete Plan.

3 OFERTAT: PËRGATITJA

Përgatitja e Ofertave

3.1.1 Dokumentet që Përbëjnë Ofertën

Gjatë dorëzimit të Ofertës sipas Seksionit 4, dokumentet për tu dorëzuar janë si më poshtë:

(a) propozimi teknik, përfshirë dokumentet e mëposhtme (së bashku, "Oferta Teknike"):

- i. Formulari i aplikimit të Ofertës;
- ii. Garancia e Ofertës e kërkuar nga Seksioni 3.2;
- iii. Versioni i fundit i Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve, me secilën faqe të saj me inicialet e Ofertuesit;
- iv. Prokura e noterizuar e kërkuar nga Seksioni 3.3;
- v. Deklarata e konfliktit të interesave të kërkuar nga Seksioni 3.3;
- vi. Kualifikimet dhe kushtet e kërkuara për Ofertuesin nga Seksioni 3.4;

- vii. Deklaratat e komisioneve dhe shpërblimeve të kërkuara nga Seksioni 3.8;
- viii. Çertifikata e regjistrimit të Ofertuesit në Regjistrin e Tregëtisë dhe Kompanive apo çdo dokument tjetër i barazvlefshëm i lëshuar nga autoriteti përkatës vendor; dhe
- ix. Plani i Biznesit;
- x. formulari i konfirmimit të kushteve minimale të detyrueshme të performancës teknike.

(b) propozimi financiar ("**Oferta Financiare**").

3.1.1. Çdo e dhënë e rreme do të përbëjë një bazë ligjore për skualifikimin e Ofertuesit, dhe çdo zbulim që Ofertuesit të ketë përdorur informacion material të rremë apo ka fshehur informacion material në Ofertën e tij do të përbëjë një bazë për ndërprerjen e marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve. Ofertuesit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarte të Proçesit të Tenderimit, pa u bërë modifikime kushteve të tyre.

3.2 Garancia e Ofertës

3.2.1 Si pjesë e Ofertës së tij Teknike, Ofertuesi do të dorëzojë një garanci të Ofertës, e pagueshme për METE, në vlerën e 10 % të Ofertes Financiare ("Garancia e Ofertës").

3.2.2 Garancia e Ofertës do të jetë një letër garancie e lëshuar nga një bankë apo institucion financiar i respektuar. Nëse institucioni që ka lëshuar Garancinë e Ofertës është i regjistruar jashtë Shqipërisë, Garancia e Ofertës do të lëshohet nga një degë shqiptare apo një institucion financiar korrespondues i regjistruar në Shqipëri për ta bërë atë të zbatueshme. Ofertuesit do të sigurojnë që Garancia e Ofertës të mbetet e vlefshme për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës origjinale (siç përshkruhet në Seksionin 3.9.1) dhe tridhjetë (30) ditë pas çdo zgjatjeje që kërkohet më pas nga METE në përputhje me Seksionin 3.9.2.

3.2.3. Çdo Ofertë që nuk shoqërohet nga një Garanci Oferte e pranueshme, do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si një ofertë që është e paplotë. Garancia e Ofertës së një Ofertuesi që është një shoqëri e bashkuar duhet të jetë në emër të të gjithë anëtarëve të shoqërisë së bashkuar që dorëzon Ofertën.

3.2.4 Qëllimi i Garancisë së Ofertës është të sigurojë që Ofertuesi Fitues do të zbatojë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike pas njoftimit të Ofertuesit Fitues, Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve kryesisht në formën e kopjes së shënuar me initiale të përfshirë në Ofertën e tij.

3.2.5 METE do të kthejë Garancitë e Ofertave të Ofertuesve të pasuksesshëm sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës (siç mund të zgjatet në përputhje me Seksionin 3.9.2).

3.2.6 Garancia e Ofertës e Ofertuesit Fitues (siç përshkruhet në Seksionin 5.8) do të kthehet në momentin e përmbylljes së Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve).

3.2.7 Garancia e Ofertës mund të konfiskohet, sipas gjykimit të METE-s:

- a) nëse Ofertuesi (apo çdo anëtar i një shoqërie të bashkuar, nëse Ofertuesi është një shoqëri e bashkuar) bën një shtrembërim të konsiderueshem në Ofertën e tij;
- b) nëse Ofertuesi Fitues tërheq Ofertën e tij gjatë Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës;

- c) nëse Ofertuesi Fitues nuk zbaton Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve, në formën e kopjes me initiale të përfshirë në Ofertën e tij në një datë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas shpalljes së Ofertuesit Fitues; ose
- d) nëse Ofertuesi Fitues nuk arrin të mbyllë Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve për arsye që i atribuohen Ofertuesit Fitues.

3.2.8 Garancia e Ofertes do të jetë e pagueshme me kërkesën e parë të METE-s në rastin kur ndodh një ose më shumë nga rrethanat e përshkruara në Seksionin 3.2.7 më sipër.

3.2.9 Konfiskimi i Garancisë së Ofertës nuk do të pengojë METE-n të ndjekë çdo masë tjetër që mund të ketë kundër Ofertuesit Fitues apo një Ofertuesi tjetër, sipas ligjeve të Shqipërisë.

3.3 Prokura

Në Ofertën Teknike, çdo Ofertues (ose nëse Ofertuesi është një bashkim i perkohshëm i shoqerive, çdo anëtar i shoqerise se perbashket) do të dorëzojë një prokurë me shkrim e noterizuar, që përcakton se personi apo personat që nënshkruajnë Ofertën kanë autoritetin të nënshkruajnë Ofertën dhe që Oferta është e detyrueshme për ofertuesin gjatë të gjithë Periudhës së plotë të Vlefshmërisë së Ofertës.

Në Ofertën Teknike, çdo Ofertues (ose nëse Ofertuesi është bashkim i perkohshëm i shoqerive, çdo anëtar i shoqerise se perbashket) do të dorëzojë një deklaratë me shkrim për konfliktin e interesit në lidhje me çdo konflikt interesi ekzistues, potencial, të mundshëm apo të ardhshëm që Ofertuesi (apo secili anëtar i një bashkimi te perkohshëm i shoqerive) mund të ketë me Proçesin e Tenderit, Projektin, METE-n apo çdo agjenci, konsulent apo këshilltar të saj. Për qëllimin e këtij Seksioni, "konflikti i interesit" do të përcaktohet dhe interpretohet sipas ligjit shqiptar.

3.4 Kualifikimet dhe Kushtet e Kerkuara per Ofertuesit

Në Ofertën Teknike, secili Ofertues do të japë një informacion të detajuar mbi çdo ndryshim që mund të ketë ndodhur ndërmjet kohës së dorëzimit të Aplikimit Parakualifikues dhe Ofertës së tij, të cilët mund të kenë ndonjë ndikim material mbi pranueshmërinë dhe kualifikimeve të Ofertuesit për të zbatuar dhe/ose për të respektuar Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve.

3.5 Plan Biznesi

Plani i Biznesit do të përshkruajë planet strategjike, operacionale dhe financiare të Ofertuesit për periudhën e tanishme dhe pese (5) vitet vijuese të OSSH. Nëse përzgjidhet si një Ofertues Fitues (siç përshkruhet në Seksionin 5.8), Ofertuesi do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të zbatuar Planin e tij të Biznesit siç është dorëzuar.

3.6 Çmimi i Blerjes

Oferta Financiare do të përmbajë çmimin e Ofertuesit ("Çmimi i Blerjes") që duhet të shprehet si një sasi fikse në Euro për t'u paguar për blerjen e 76 perqind te aksioneve.

3.7 Pagesa e Tarifës së Suksesit nga ana e Ofertuesit Fitues

Ofertuesi Fitues do të jetë i detyruar të paguajë, përveç pagesës së Çmimit të Blerjes një sasi prej 1,360,000 USD, drejtpërdrejt në llogarinë e IFC (siç do të sqarohet në kontratë), që do të korrespondojë me pagesën e tarifës së suksesit që është e pagueshme për këtë transaksion.

3.8 Komisione dhe Shpërblime

Në Ofertën Teknike, secili Ofertues do të japë informacion të detajuar që rendit të gjithë komisionet dhe shpërblimet, nëse ka, të paguara apo për t'ju paguar nga Ofertuesi agentëve në lidhje me Ofertën apo Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve. Ofertuesi do të renditë emrin dhe adresën e çdo agjenti, sasinë dhe valutën e paguar apo për t'u paguar agentëve dhe qëllimin e komisionit apo shpërblimit. Nëse këto komisione ose shpërblime nuk janë paguar, Ofertuesi duhet ta japë këtë informacion në Ofertën Teknike.

3.9 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave

3.9.1 Ofertat do të qëndrojnë të vlefshme për nentëdhjetë (90) ditë nga Afati i Dorëzimit të Ofertave ("**Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**"). Një Ofertë për një periudhë më të shkurtër kohe do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si jo e plotë.

3.9.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, METE mund të kërkojë pëlqimin e Ofertuesit për një zgjatje të Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertave. Kërkesa dhe përgjigjet ndaj saj do të bëhen me shkrim. Nëse një Ofertues pranon të zgjatë Periudhën e Vlefshmërisë së Ofertave, edhe Garancia e Ofertës duhet të zgjatet në përputhje me Seksionin 3.2.2 më sipër (dhe Ofertuesit do të bëjnë të gjithë përpjekjet e arsyeshme për këtë). Një Ofertues mund të refuzojë kërkesën e Autoritetit Kontraktues për zgjatje të periudhës pa ju konfiskuar Garancia e Ofertës. Një Ofertues që do të plotësojë këtë kërkesë nuk do t'i kërkojë apo lejohet të ndryshojë Ofertën e tij.

3.10 Formatit dhe Nënshkrimi i Ofertave

3.10.1 Ofertuesi do të përgatisë një origjinal dhe një numër kopjesh të Ofertës së tij siç specifikohet në Fletën e të Dhënave të Ofertës, duke shënuar qartësisht secilën si "**OFERTË - ORIGJINALE**", "**Ofertë – KOPJE NR. 1**", "**Ofertë – KOPJE NR. 2**", etj., siç do të jetë e përshatshme. Në rast të ndonjë mospërputhje ndërmjet origjinalit dhe ndonjë kopjeje, origjinali do të ketë përparësi.

3.10.2 Origjinali dhe kopjet e Ofertës do të shtypen dhe nënshkruhen nga Ofertuesi apo personi(at) që janë autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar Ofertuesin. Autorizimi i këtij të fundit do të shënohet nga një prokurë e dorezuar si pjesë e Ofertës Teknike në përputhje me Seksionin 3.3. Të gjitha faqet e Ofertës, përveç literaturës së shtypur të paamenduar, do të siglohet nga personi apo personat që nënshkruajnë këtë Ofertë.

3.10.3 Oferta nuk do të përmbajë ndryshime, lënie jashtë apo shtesa, përveçse në rastet kur këto korrigjime janë sigluar nga personi apo personat që e nënshkruajnë Ofertën.

4. OFERTAT: DORËZIMI

4.1 Vulosja dhe Shënimi i Ofertës

4.1.1 Ofertuesit do të vulosin origjinalin dhe secilën kopje të Ofertës në zarfë të veçanta, të shënuara siç duhet si "**OFERTË - ORIGJINALE**", "**Ofertë – KOPJE NR. 1**", "**Ofertë – KOPJE NR. 2**", etj. Zarfet do të vulosen në një zarf të jashtëm.

4.1.2 Zarfet e brendshme dhe të jashtme do të vulosen me vulën e Ofertuesit, të adresuara për METE, në adresën që është dhënë në Fletën e të Dhënave të Ofertës, dhe mbajnë fjalët "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH: OFERTË. MOS TË HAPET PËRPARA DATËS 1 SHTATOR 2008**" për t'u plotësuar me datën dhe orën e specifikuar në Fletën e të Dhënave të Ofertës.

4.1.3 Secili nga zarfet e brendshme duhet të ketë emrin dhe adresën e Ofertuesit, me qëllim që Oferta të kthehet e pahapur në rast se deklarohet 'e vonuar'.

4.1.4 Nëse zarfi i jashtëm nuk është i vulosur dhe shënuar siç kërkon Seksioni 4.1.2, METE nuk do të marrë asnjë përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme. Nëse zarfi i jashtëm zbulon identitetin e Ofertuesit, METE nuk do të garantojë anonimitetin e dorëzimit të Ofertës, por zbulimi i identitetit nuk do të përbëjë arsye për refuzimin e Ofertës.

4.1.5 Ofertuesit do të përfshijnë në çdo zarf:

- a) Një zarf të vulosur që mban fjalët "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH: OFERTË TEKNIKE**", që do të përmbajë Ofertën Teknike të Ofertuesit;

dhe

- b) Një zarf i vulosur që mban fjalët "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH: OFERTË FINANCIARE**", zarf i cili do të përmbajë Ofertën Financiare të Ofertuesit.

4.1.6 Secili zarf i Ofertës Teknike dhe zarfi i Ofertës Financiare do të shënojnë emrin dhe adresën e Ofertuesit.

4.1.7 Çdo Ofertë që nuk përputhet me udhëzimet specifikuar do ta bëjnë Ofertën të pavlefshme.

4.2 Afati për Dorëzimin e Ofertave

4.2.1 Ofertat duhet të merren nga METE në adresën e specifikuar në Fletën e të Dhënave të Ofertës jo më vonë se data dhe ora e deklaruar si "**Afati për Dorëzimin e Ofertave**".

4.2.2 METE mund të zgjasë, sipas vetëgjyqimit të saj, Afatin për Dorëzimin e Ofertave duke ndryshuar Dokumentat e Tenderit në përputhje me Seksionin 2.3.3, rast në të cilin të gjithë të drejtat dhe detyrimet e METE-s dhe të Ofertuesit pas kësaj do të jenë subjekt i afatit siç është zgjidhur.

4.3 Ofertat e Vonuara

Çdo Ofertë e marrë nga METE pas Afatit për Dorëzimin e Ofertave do të refuzohet dhe kthehet e pahapur Ofertuesit.

4.4 Modifikimi dhe Tërheqja e Ofertave

4.4.1 Ofertuesi mund të ndryshojë apo tërheqë Ofertën e tij pas dorëzimit, nëse METE merr një njoftim me shkrim të ndryshimit apo tërheqjes përpara Afatit për Dorëzimin e Ofertave.

4.4.2 Ndryshimet e Ofertuesit do të përgatiten, vulosen, shënohen dhe dërgohen si më poshtë:

- a) Ofertuesi do të japë një origjinal dhe numrin e kopjeve të specifikuar në Fletën e të Dhënave të Ofertës, për çdo ndryshim të bërë Ofertës së tij, të identifikuara qartësisht si të tilla, në dy zarfe, të shënuara siç duhet "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH – NDRYSHIME TË OFERTËS - ORIGINAL**" dhe "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH –**

NDRYSHIME TË OFERTËS - KOPJE". Zarfet do të vulosen brenda një zarfi të jashtëm, që do të shënohet siç duhet "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH – NDRYSHIME TË OFERTËS**".

- b) Dispozita të tjera në lidhje me shënimin dhe dërgimin e ndryshimeve të Ofertës do të jenë në përputhje me Seksionin 4.1.2 deri në 4.1.6.

4.4.3 Një Ofertues që dëshiron të tërheqë Ofertën e tij do të njoftojë METE-n me shkrim përpara Afatit për Dorëzimin e Ofertave. Njoftimi i tërheqjes:

- (a) do t'i adresohet METE-s në adresën e deklaruar në Fletën e të Dhënave të Ofertës; dhe
- (b) do të mbajnë emrin e Projektit dhe fjalët "**PROJEKTI I PRIVATIZIMIT TË OSSH – NJOFTIM I TËRHEQJES SË OFERTËS**". Njoftimet e Tërheqjes së Ofertave të marra pas Afatit për Dorëzimin e Ofertave do të injorohen, dhe Oferta e dorëzuar do të konsiderohet sikur është dërguar.

4.4.4 Çdo tërheqje e një Oferte në intervalin ndërmjet Afatit për Dorëzimin e Ofertave dhe përfundimit të Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës të specifikuar në Seksionin 3.9.1 do të rezultojë në konfiskimin e Garancisë së Ofertës, në vijim të Seksionit 3.2.

5 OFERTAT: HAPJA DHE VLERËSIMI

5.1 Hapja e Ofertave Teknike

5.1.1 Hapja e Ofertave Teknike do të jetë publike.

5.1.2 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të lexojë emrin dhe adresën e secilit Ofertues në praninë e përfaqësuesve të Ofertuesve dhe do të hapë zarfet e vulosura që përmbajnë Ofertat Teknike në datën, orën dhe vendin e shënuar në Fletën e të Dhënave të Ofertës. Përfaqësuesit e Ofertuesve të cilët janë të pranishëm do të nënshkruajnë një regjistër që provon praninë e tyre.

5.1.3 Zarfet e jashtme të shënuar "**TËRHEQJE**" do të hapen të parat dhe emri i Ofertuesit do të lexohet me zë të lartë. Ofertat për të cilën është dorëzuar një kërkesë e pranueshme për tërheqje sipas Seksionit 4.4 nuk do të hapen. Ofertat e pahapura nuk do të merren në konsideratë për vlerësim, pavarësisht nga rrethanat.

5.1.4 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të hapë zarfin e Ofertave Teknike, duke përfshirë edhe ndryshimet e bëra në bazë të Seksionit 4.4.

5.1.5 Asnjë Ofertë nuk do të refuzohet në hapjen e zarfit të Ofertës Teknike përveç Ofertave të vonuara sipas Seksionit 4.3.

5.2 Vlerësimi i Ofertave

5.2.1 Ofertat do të vlerësohen mbi një kombinim të kushteve minimale të detyrueshme të performances teknike dhe Çmimit të Blerjes. Kushtet minimale të detyrueshme të performances teknike dhe menyra e vlerësimit të ofertave do të perkufizohen në një vendim të veçantë të Keshillit të Ministrave, në një periudhë të përshtatshme kohore para afatit të paraqitjes së ofertave të detyrueshme

5.2.2 Pas hapjes së secilës Oferte Teknike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shqyrtojë Ofertat Teknike për të përcaktuar nëse ato janë të plota dhe në përputhje me Udhëzimet për Ofertuesin. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të sigurojë edhe që formulimi i Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve të sigluar përputhet me versionin final të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve të shpërndarë Ofertuesve përpara Afatit të Dorëzimit të Ofertave.

5.3 Hapja e Ofertave Financiare

5.3.1 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të hapë zarfat e Ofertave Financiare, përfshirë ndryshimet e bëra sipas Seksionit 4.4.

5.3.2 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të ketë tre (3) ditë nga data e hapjes së Ofertave Financiare për t'i vlerësuar ato në përputhje me piken 5.2.3.2.

5.3.3 Brenda tre (3) ditëve nga hapja e Ofertave Financiare, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave do të përgatisë një raport përmbljedhës ("**Raporti i Vlerësimit**") dhe do të propozojë një Ofertues të preferuar për METE-n.

Raporti i Vlerësimit do të përfshijë:

- (a) objektin e Proçesit të Tenderimit dhe përqindjen e aksioneve të ofruara për shitje;
- (b) një përmbljedhje të shkurtër të procedurës dhe numrit të Ofertave të dorëzuara;
- (c) një përmbljedhje të Ofertave të dorëzuara;
- (d) kriteret kryesore për vlerësimin e Ofertave dhe vlerësimin e secilës Ofertë;
- (e) kriteret për vlerësimin e Çmimit të Blerjes; dhe
- (f) një klasifikim të Ofertuesve në bazë të vlerësimit të kryer për Ofertat e tyre përkatëse.

5.3.4 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të dorëzojë Raportin e Vlerësimit në Këshillin e Ministrave. Pas miratimit të Ofertuesit Fitues nga Këshilli i Ministrave, METE do të ketë të drejtën të hyjë në Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve me Ofertuesin Fitues.

5.4 Pavlefshmëria dhe dështimi i Proçesit të Tenderimit

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të mos marrë parasysh ndonjë mos-përputhje apo parregullsi të vogël në një Ofertë e cila nuk përbën një shmangie thelbësore dhe nuk paragjykon apo prek renditjen relative të ndonjë Ofertuesi si rezultat i vlerësimit të Ofertës Teknike dhe Ofertës Financiare.

Një Ofertë deklarohet si e pavlefshme kur:

- (a) Ofertuesi nuk ka dorëzuar Garancinë e Ofertës;
- (b) Ofertuesi ka shkelur konfidencialitetin ose ka dhënë të dhëna të rreme në ofertën e tij/saj;

- (c) Ofertuesi nuk ka plotësuar ndonjë nga kërkesat që përmbahen në këto Udhëzime për Ofertuesit.

Proçesi i Tenderimit konsiderohet i pasuksesshëm nëse:

- (a) asnjë nga Ofertat nuk përmbush kërkesat e këtyre Udhëzimeve për Ofertuesit;
- (b) Këshilli i Ministrave vendos të ndërpresë Proçesin e Tenderimit për shkak të mungesës së zbatueshmërisë ekonomike të Projektit; ose
- (c) nuk është paraqitur asnjë oferte.

METE nuk do të ketë asnjë detyrim cilido qoftë ai, në ushtrimin e ndonjërës prej të drejtave sipas këtij Seksioni.

5.5 Kontaktimi i METE-s ose Autoriteteve

5.5.1 Që nga momenti i hapjes së Ofertave deri në momentin e ekzekutimit të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve, nëse ndonjë Ofertues dëshiron të kontaktojë METE, duhet ta bëjë këtë nëpërmjet e-mail në adresën dkraja@mete.gov.al, duke i dërguar një kopje të çdo korrespondence Drejtuesit të Ekipit të Projektit të IFC.

5.5.2 Nëse një Ofertues apo Ofertuesi Fitues (i) përdor mashtrimin në marrëdhëniet me METE-n, Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, këshilltarët, punonjësit, konsulentët apo agjentët e saj, ose në marrëdhëniet me Projektin; ose (ii) provohet që personalisht apo nëpërmjet një ndërmjetësi, ka ofruar apo është përpjekur të ofrojë një mitë ndonjë punonjësi të METE-s që është i përfshirë me Ofertat ose me Projektin, atëherë Oferta e Ofertuesit apo Oferta e Ofertuesit Fitues do të anulohet dhe Garancia e Ofertës do të konfiskohet.

5.5.3 Gjithashtu, si rezultat i ndonjë sjelljeje të gabuar të parashikuar në Seksionin 5.5.2, një Ofertues ose Ofertuesi Fitues (sipas rastit) do të ndalohet të marrë pjesë në tendera publike, privatizim apo partneritete publike private të çdo lloji në Shqipëri, qoftë kombëtare apo lokale.

5.6 ANKIMIMI

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do t'u njoftojë përfundimin e vlerësimit kandidatëve pjesëmarrës, të cilët brenda 5 diteve nga data e marrjes së njoftimit mund të kundërshtojnë vlerësimin pranë Ministrisë përgjegjëse për ekonominë i cili shqyrton ankimin dhe kthen përgjigjen brenda 10 dite pune nga data e marrjes së ankimit.

5.7 MIRATIMI I VLERËSIMIT

5.7.1 Komisioni do t'i paraqesë Këshillit të Ministrave raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave, të klasifikuara në përputhje me kriteret e përmendura në pikën 5.2 "Vlerësimi i Ofertave" Këshilli i Ministrave miraton raportin e vlerësimit të ofertave dhe shpall kandidatin fitues.

5.7.2 Këshilli i Ministrave, mundet që në çdo kohë përpara shpalljes së fituesit, të anulohet procedura e tenderit pa dhënë argumenta kandidatëve.

5.8 Përcaktimi i Ofertuesit Fitues dhe Sesionet e Finalizimit

5.8.2 METE do të shpallë njoftimin për Ofertuesin fitues, ofertuesin oferta e të cilit ka arritur pikët më të larta finale ("Ofertuesi Fitues"). Ofertuesi Fitues do të ftohet të marrë pjesë në sesionet finalizuese të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve dhe të zbatojë Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit të Ofertuesit Fitues. Ndonëse METE mund të bëjë ndryshime të vogla në hartim, me synimin për të qartësuar dhe finalizuar Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve, Ofertuesit Fitues do t'i kërkohet të zbatojë Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve në formën e kopjeve të sigluara të dorëzuara si pjesë të Ofertës së tij Teknike.

5.8.3 Negociatat me Ofertuesit si dhe finalizimi i Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve me Ofertuesin Fitues do të kryhen me ndihmën e International Finance Corporation (IFC).

5.8.4 Me zbatimin e Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve nga Ofertuesi Fitues, METE do të njoftojë menjëherë emrin e Ofertuesit Fitues secilit prej Ofertuesve të pasuksesshëm dhe do të lëshojë Garancitë e Ofertave për Ofertuesit e pasuksesshëm.

5.8.5 Nëse brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të Ofertuesit Fitues, bëhet e qartë për METE-n që Ofertuesi Fitues nuk do të zbatojë Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve, METE do të ketë të drejtën për të konfiskuar Garancinë e Ofertës së Ofertuesit Fitues dhe do të ftojë për negociata Ofertuesit e tjerë sipas renditjes së tyre, derisa Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve të zbatohet ose përndryshe refuzon të gjithë Ofertat e mbetura..

5.9 Konfidencialiteti

METE dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të ruajnë fshehtësinë e të gjithë të dhënave teknike, ekonomike dhe financiare të Ofertuesve. Përveç rasteve të parashikuara me ligj, vendim gjykatë apo në këto Udhëzime për Ofertuesit, METE dhe Ofertuesit nuk do t'u japin palëve të treta informacione teknike, të dhëna për çmimin dhe ndonjë element tjetër që është subjekt i diskutimit pa marrë pëlqimin e palës tjetër, përveçse këshilltarëve dhe konsulentëve të tyre në lidhje me Projektin.

5.10 Miratimi i kontrates

Kontrata pasi firmoset nga Ministria përgjegjëse për ekonomine dhe bleresi, miratohet nga Keshilli i Ministrave dhe Parlamenti.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.7.2008
Doli nga shtypi më 18.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë